



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 11 datë 29/11/1996

**PER**  
**“MIRATIM FONDI PER FESTIMIN E VITIT TE RI DHE FESTES SE**  
**KRISHTLINDJEVE”.**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, në mbledhjen e tij të dt.29.11.1996, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Kulturës për organizimin në Tiranë të festimeve të Vitit të Ri dhe të Krishtlindjeve me qëllim që të krijohet një atmosferë sa më festive në qytet, në mbështetje të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.673, dt.29.11.1995 për financimet të mundshme nëpërmjet fondit të Bashkisë,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë fondin prej 4 milion lekësh për organizimin e veprimtarive të Vitit të Ri sipas zërave dekor, ndriçim, aktivitet artistik.
2. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Kulturës për zbatimin e këtij vendimi në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**